



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.168

17 dhjetor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.798, datë 21.11.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi i rrëshqitjeve në segmentin rrugor Fier-Ura e Povelës	5035
Vendim i KM nr.800, datë 21.11.2007	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Leskovik të qarkut të Korçës	5047
Vendim i KM nr.801, datë 21.11.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Selenicë të qarkut të Vlorës	5048
Vendim i KM nr.802, datë 21.11.2007	Për përcaktimin e rasteve të shpenzimeve të panjohura, për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm	5048
Vendim i KM nr.805, datë 21.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Stojan” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	5049
Vendim i KM nr.806, datë 21.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Kukur 2” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	5049
Vendim i KM nr.808, datë 21.11.2007	Për dhënie fondi komunës Tërthorë, për realizimin e procedurave për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë	5050
Vendim i KM nr.811, datë 29.11.2007	Për miratimin e kuotave të pranimit dhe të tarifës së shkollimit në programin e studimeve të ciklit të dytë, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2007-2008	

5050

Vendim i KM nr.812, datë 29.11.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Nikël të qarkut të Durrësit	5051
Vendim i KM nr.813, datë 29.11.2007	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Patos të qarkut të Fierit	5051
Vendim i KM nr.814, datë 29.11.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.663, datë 18.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për rishpërndarjen e fondit të kontigjencës, të parashikuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”...	5052
Vendim i KM nr.815, datë 29.11.2007	Për miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Gardën e Republikës	5052
Vendim i KM nr.816, datë 29.11.2007	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Horë-Vranisht të qarkut të Vlorës	5063
Vendim i KM nr.817, datë 29.11.2007	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Kukës të qarkut të Kukësit	5064
Vendim i KM nr.818, datë 29.11.2007	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Golem të qarkut të Fierit	5065
Vendim i KM nr.821, datë 5.12.2007	Për krijimin e disa njësive kryesore, fakulteteve të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	5066
Vendim i KM nr.822, datë 5.12.2007	Për ndryshimin e emërimit dhe riorganizimin e njësive kryesore, fakulteteve të Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë	5067
Vendim i KM nr.823, datë 5.12.2007	Për krijimin e disa njësive kryesore, fakulteteve të Universitetit “Eqerem Çabej”, Gjirokastër	5068
Vendim i KM nr.824, datë 5.12.2007	Për krijimin e disa njësive kryesore, fakultete, në Universitetin Politeknik të Tiranës	5068
Vendim i KM nr.828, datë 5.12.2007	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për dhënien e asistencës financiare (GRANT), për kryerjen e studimit të fizibilitetit, për investimet për sigurinë e digave, në kaskadat e lumenjve, Drin dhe Mat	5069
Vendim i KM nr.829, datë 5.12.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për disa bashki	5070
Vendim i KM nr.838, datë 5.12.2007	Për një shtesë në vendimin nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”	5070

VENDIM
Nr.798, datë 21.11.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REHABILITIMI I
RRËSHQITJEVE NË SEGMENTIN RRUGOR FIER-URA E POVLËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi i rrëshqitjeve në segmenti rrugor Fier-Ura e Povelës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 13 003 m², tokë arë, të vlerësuar me çmimet 400 lekë/m², 600 lekë/m², 700 lekë/m², 900 lekë/m² dhe 1 000 lekë/m² me vlerë prej 11 097 000 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, për sipërfaqen 3 764 m², kultura bujqësore, me vlerë 20 123 (njëzet mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë, dru frutorë, me vlerë 6 400 (gjashtë mijë e katërqind) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 11 123 523 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 252 500 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 11 123 523 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 20.11.2007 dhe të përfundojë më 20.12.2007.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MPPTT

Qarku Fier

LISTA E PRONAREVE QE PREKEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR FIER - URA POVEL



Nr.	Emër	Atesi	Mbiemër	Toka Bujqesore			Kulture bujqesore			Kultura drufutore			Vlera totale Leke	Shenime	
				Numri i pasurisë	Sip. (m2)	Cmimi m2	Vlera leke	Sip.m2	Leke/ha	Vlera /leke	Ullinj rrenje	Molle rrenje			vlera leke
Rreshqitja Nr. 1															
1	Dashurie		Canaj		260	900		234000	260	45000	1170		235170	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitja Nr. 2															
1	Bibil		Brahimi	5/2	93	1000		93000					93000	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitja Nr. 3															
1	I pa identifikuar				275	700		192500	206	50000	1030		193530	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitja Nr. 4															
1	I pa identifikuar				1100	700		770000					770000	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitja Nr.5															
1	I pa identifikuar				316	400		126400	316	35000	1106		127506	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitja Nr.6															
1				143/29								1	1200		
	Bashkepronare			143/30	875	600		525000				3	2	5200	
Rreshqitje Nr. 7															
1	Sadik		Malaj	143/2	120	600		72000					72000	Plotësim dokumentacioni	
3	I pa identifikuar			39/14	23	600		13800					13800	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitje Nr. 8															
1	Lefter	Haxhi	Lamaj	510/40	1234	1000		1234000	1234	60000	7404		1241404	Plotësim dokumentacioni	
2	Esma	Kamber	Sheme	429/1	673	900		605700	673	60000	4038		609738	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitje Nr. 9															
1	Kujtim		Licaj	429/11	1300	900		1170000					1170000	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitje Nr. 10															
3	Dervish		Sellaj	429/25	3914	900		3522600					3522600	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitje Nr. 11															
4	Rexhep		Taulaj	429/28	2820	900		2538000	1075	50000	5375		2543375	Plotësim dokumentacioni	
Rreshqitje Nr. 12															
	Shuma				13003		11097000	3764		20123		6400	11123523		



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTVE DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

RRESHQITJET "FIER - URA E POVLES" (PROJEKT - ZBATIMI)


PLANIMETRIA E SHPRONESIMEVE



CONSULENTI: L.C.P. 04		REPUBLICA E SHQIPERISE MINISTRIA E TRANSPORTVE DHE TELEKOMUNIKACIONIT DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE	
INVESTICIONI: INFRA CONSULT PROJECT- 04 SHPK		INVESTICIONI: DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE	
TETOR 2005		GRUPIT PROJEKTIMIT: 04	
PROJEKTES: Ing. D. HALLAJ		DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE	
PROJEKTES: Ing. A. SOLLAKU		Ing. D. HALLAJ	
PROJEKTES: Ing. S. HAXHIRAJ		Ing. A. SOLLAKU	
PROJEKT - ZBATIMI		1.005	


RRESHQITJA Nr. 1

BALSH




$$S = S_1 + S_2 = 108 + 152 = 260 \text{ m}^2$$

SIPERFATIA E SHIFRONJUNJH
RRUGA EKZISTUESE



I.C.P. - 04 INFRA CONSULT PROJECT 04 Sh.p.k			
OBJEKT:	RRESHQITJET	P/ZAATIM	
	"FIER - URA E POVLES"	TETOR 2003	
EMERTIMI:	RRESHQITJA N° 7	SHK. 1500	
PLANIMETRIA E SHPREHESIMEVE		07/6-2002	


 QJERT
 31.04
 11




REPUBLIKA E SHQIPERISE	
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE	
I.C.P.- 04 INFRA CONSULT PROJECT-04 Sh.p.k	
OBJEKTI	P/ZBATIM
RRESHQITJET	TETOR 2005
"FIER - URA E POVLES"	SHK 1.500
RRESHQITJA Nr. 3	PLANIMETRIA E SHPRONESIMEVE
	03/6-1/01




RRESHQITJA Nr. 3

$$S = 92 \times 2.98 = 275.12$$




DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGES	
I.C.P.	INFRA CONSULT PROJECT - 04 Sh.p.k
OBJEKTI	
RRESHQITJET	
"FIER - URA E POVLES"	
TETOR 2005	
Shk. 1:500	
RRESHQITJA Nr. 4	
PLANIMETRIA E SHPRONESIMEVE	
04/0- 101	

RRESHQITJA Nr. 4



REPUBLIKA E SHQIPERISE	
DIREKTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE	
I.C.P.- 04 INFRA CONSULT PROJECT- 04 Sh.p.k	
OBJEKTI	P/2B/ATIM
RRESHQITJET	
"FIER - URA E POVLES"	
EMETIMI	TETOR 2003
RRESHQITJA Nr. 5	
PLANIMETRIA E SHPRONESIMEVE	Shk. 1:500
056- 101	

RRESHQITJA Nr. 5




REPUBLIKA E SHQIPERISE	
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE	
I.C.P. 04	INFRA CONSULT PROJECT 04 SH.P.A
OBJEKTI:	PIZBATIM
RRESHQITJET	
"FIER - URA E POVLES"	
RRESHQITJA Nr. 6	
SKALA:	SHK. 1:500
PLANIMETRIA E SHPRONESIMEVE	
06/6- 1/01	

RRESHQITJA Nr. 6

$$S = 40 + 169 + 154 + 186 + 270 + 170 + 105 + 68 + 112 + 60 = 1384 \text{ m}^2$$

NO! sipërfaqe pe shpronesohet akte

$$S = 875 \text{ m}^2$$





REPUBLIKA E SHQIPERISE	
DREKTORIA E PERCUTHTSHME E RRUGE	
I.C.P. - 04 INFRA CONSULT PROJECT 04 S.	
OBJEKTI	P/2BA'
RRESHQITJET	
"FIER - URA E POVLES"	
TEKOR	2
PLANIMETRIA	SHK. 1:5
RRESHQITJA Nr. 7	
PLANIMETRIA E SHPRONESIMEVE	
076-1	

RRESHQITJA Nr. 7



S18 - 190.602



$$S = \frac{45 + 25 + 63 + 45 + 95 + 113 + 50}{7} = 438M2$$


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
I.C.P.-04 INFRA CONSULT PROJECT 04 SH-2-X

I.C.P.- 04 INFRA CONSULT PROJECT-04 S.N.P.K

VENDIM
Nr.800, datë 21.11.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LESKOVIK TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Leskovik të qarkut të Korçës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Leskovik, miratuar me vendimin nr.600, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Leskovikut”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Leskovikut për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Leskovik

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1, 2, 3, 4, 5, 6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
51, 52-60	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile	Në pronësi
398	Shërbime funerale	Në pronësi
69-150, 61-64, 397	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
151-396	Prona që përdoren për në fushën e infrastrukturës (troje)	Në përdorim
31, 32, 33	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën sociale	Në pronësi
12, 13, 14	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
15, 16, 17, 18	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM
Nr.801, datë 21.11.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË SELENICË TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të bashkisë Selenicë, të qarkut të Vlorës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 27 (njëzet e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 109 (njëqind e nëntë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.802, datë 21.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE TË SHPENZIMEVE TË PANJOHURA, PËR EFEKT TË PËRCAKTIMIT TË FITIMIT TË TATUESHËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.8433, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshirjen nga rregulli i përcaktuar në shkronjën “n” të nenit 21 të ligjit nr.8433, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari:

- a) në zonat, të cilat nuk mbulohen nga rrjeti i sistemit bankar;
- b) në institucionet financiare jobankare, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

2. Në zonat të cilat nuk mbulohen nga rrjeti i sistemit bankar, pagesat e pagave, shpërblimet dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të punonjësve të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, të bëhen nga Posta Shqiptare sh.a., sipas kriterëve të licencës së marrë nga Banka e Shqipërisë dhe nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.805, datë 21.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “STOJAN”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Stojan”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 7.5 përqindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese për zgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “EL-ER Energy” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.806, datë 21.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “KUKUR 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Kukur 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 6.5 përqindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Elira” sh.p.k.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.808, datë 21.11.2007

PËR DHËNIE FONDI KOMUNËS TËRTHORË, PËR REALIZIMIN E PROCEDURAVE PËR ZHVENDOSJEN E VARREZAVE TË FSHATIT MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Tërthorë t’i jepet fondi prej 11 240 000 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet mijë) lekësh, për realizimin e procedurave për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë, si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Kalimash-Morinë, pjesë e autostradës Durrës-Kukës-Morinë.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Procedurat për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë të përfundojnë, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe komuna Tërthorë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.811, datë 29.11.2007

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË
PROGRAMIN E STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, PRANË FAKULTETIT TË
INXHINIERISË ELEKTRIKE, TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR
VITIN AKADEMIK 2007-2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, pika 4 e 75, pika 3 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në programin e studimeve të ciklit të dytë, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2007-2008, të jenë, si më poshtë vijon:

- Inxhinieri Elektronike----- 20;
- Inxhinieri e Telekomunikacionit----- 20;
- Inxhinieri Informatike----- 25.

2. Tarifa e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, për vitin akademik 2007-2008, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.812, datë 29.11.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN NIKËL TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të komunës Nikël të qarkut të Durrësit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 99 (nëntëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 538 (pesëqind e tridhjetë e tetë).

2. Ndryshimet, që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.813, datë 29.11.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË PATOS TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të bashkisë Patos të qarkut të Fierit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 42 (dyzet e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 210 (dyqind e dhjetë).

2. Ndryshimet, që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.814, datë 29.11.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.663, DATË 18.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RISHPËRNDARJEN E FONDIT TË KONTIGJENCËS, TË
PARASHIKUAR NË BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2007”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.663, datë 18.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 900 000 000 (nëntëqind milionë) lekësh, nga të cilat:

i) 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, në programin “Policia e Shtetit”, zëri “Investime për blerje automjesh”;

ii) 800 000 000 (tetëqind milionë) lekë, në programin “Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor”, zëri “Investime për infrastrukturën vendore për objektet në proces”.”.

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi 100 000 000 (njëqind milionë) lekë në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Investime”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.815, datë 29.11.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË TË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BRENDSHME, PËR GARDËN E REPUBLIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Gardën e Republikës, sipas formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Lista, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 10 (dhjetë) fletë.

2. Ngarkohen komandanti i Gardës së Republikës, Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Indentifikimi i SHQIPTARËVE
- Teknike Ndërmjet Gardes
- Kryetar i Degës Logjistike

[illegible]

[illegible]

[illegible]

[illegible]

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror MB (Garda e Republikës Tirane) Bashkia/komuna Tirane Fusha e përdorimit të Pronës : Ruajtje Rendi				Indentifikoi : Lumburi LUGA - Teknike Ndërtimit Gardes Supervizori : Kolonel Maliq MALIQAJ - Kryetar i Bëges Logjistike MIRATOHET Kolonel Ndreja PRENDI - Komandant i Gardes Republikës						
Nr. R en	A		Emertesa e pronës Vend/ndodhja/ shtrirja gjeografike	B		Permasat e pronës në m ² ose m	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti për dorëqes statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera/ shënime të veçanta
	Zona kadastrale Indeks hartës	Nr. Pasurisë		Komponente të perberës të pronës	Adresa/ve ndodhjes e komponenteve të perberës					
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			GARDA E REPUBLIKES GARNIZON							
1				Godina 12	5.1 ha	110	Dushë	Garda Republikës	Garda Republikës	1 kat tull
				Godina 13		172	Blok higjienik	Garda Republikës	Garda Republikës	1 kat tull
				Godina 14		77	Depozite karburanti	Garda Republikës	Garda Republikës	N/kat tull
				Godina 15		151	Puntoria	Garda Republikës	Garda Republikës	1 kat tull
				Tunele		5 cope		Garda Republikës	Garda Republikës	N/kat b/arme
			REP.685							
				Depo	0.7 ha	48		Garda Republikës	Garda Republikës	1 KT
2			PIKA DAJT							
				Godina 4	60 ha	340	Vila 1	Garda Republikës	Garda Republikës	1 K+bodrum
				Godina 5		340	Vila 2	Garda Republikës	Garda Republikës	1 K+bodrum
				Godina 6		340	Vila 3	Garda Republikës	Garda Republikës	1 K+bodrum
				Tunele		9 cope		Garda Republikës	Garda Republikës	N/kat b/arme
3			Q.St. Mullet							
				Godina 11	5.2 ha	295	Mag. Amb.Klasa	Garda Republikës	Garda Republikës	1 kat tull
				Godina 12		34	Menca ushtarëve	Garda Republikës	Garda Republikës	1 kat tull
				Godina 13		32	Depo	Garda Republikës	Garda Republikës	1 kat tull
				Godina 14		62	Armatura	Garda Republikës	Garda Republikës	1 kat tull
				Godina 15		40	Depo drush	Garda Republikës	Garda Republikës	1 kat B/bet
				Tunele		2 cope		Garda Republikës	Garda Republikës	N/kat b/arme

[illegible]

C

[illegible]

VENDIM
Nr.816, datë 29.11.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS HORË-VRANISHT TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Horë-Vranisht të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Horë-Vranisht të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.669, datë 4.10.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Horë-Vranisht të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Horë-Vranisht për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Horë-Vranisht

Lidhja 1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
15-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
21-41	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore&historike	Në pronësi
42-53	Infrastrukturë (shërbim funeral) shërbim publik	Në pronësi
54-59	Fusha e strehimit&mbrojtjes civile	Në pronësi
69-83	Tokë bujqësore (arë, pemëtore, vresht, ullishte)	Në përdorim
84	Tokë bujqësore PF	Në pronësi
85-653	Pyje	Në pronësi
678-684	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

VENDIM
Nr.817, datë 29.11.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KUKËS TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Kukës të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Kukës të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.650, datë 30.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Kukës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Kukësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Kukës

Lidhja 1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1, 2, 3, 4, 5, 35, 36, 37, 42, 43	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
59-69	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
74	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
97-106	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
127-130	Prona që përdoren për shërbime sociale	Në pronësi
209, 210, 211, 212, 213	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
220-222	Tokë bujqësore (arë, pemëtore, vresht)	Në përdorim
223, 224-246	Tokë bujqësore PF	Në pronësi
247	Pyje	Në pronësi
248-254	Infrastrukturë (shërbim funeral)	Në pronësi
255	Infrastrukturë (ujësjellës&kanalizime)	Në pronësi
257-402	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
403-518	Infrastrukturë sheshe e lulishte	Në pronësi
519-756, 761, 762, 763, 765-784	Fusha e strehimit&mbrojtjes civile	Në pronësi

VENDIM
Nr.818, datë 29.11.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS GOLEM TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Golem të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 50 (pesëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 256 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna e Golemit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1,2	Monumente historike e kulturore dhe buste me interesa vendore	Në pronësi
3-7	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
8-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
17-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
41-68,204-205,243,244,245,246,250,252,253	Troje të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet objekteve dhe ndërtesave të çdo lloji	Në përdorim
69-79	Varrezat publike	Në pronësi
87-103	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
23-40,106,108-129,247,248,249,251	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
134,163,169,182	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, kanale të treta dhe tokë jobujqësore	Në pronësi
136-153	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit tokë bujqësore	Në përdorim
183-193,254-256	Ujësjiellësa të veçantë të fshatrave.Kanalizime të veçanta të fshatrave	Në pronësi
194-203,206,207,209-210	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
204-241	Rrjeti i ndriçimit publik	Në pronësi

VENDIM
Nr.821, datë 5.12.2007

PËR KRIJIMIN E DISA NJËSIVE KRYESORE, FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT
“ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan:
 - a) Krijohet Fakulteti i Shkencave të Edukimit nga bashkimi i ish-Fakultetit të Mësuesisë dhe ish-Fakultetit të Shkencave Sociale, i cili të ketë këto departamente:
 - Departamentin e Metodologjisë së Mësimdhënies, që krijohet nga bashkimi i Departamentit të Pedagogji-Didaktikës me Departamentin e Arteve të Aplikuara;
 - Departamentin e Psikologjisë, Sociologjisë dhe Shkencave të Edukimit, që krijohet nga ish-Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë;
 - Departamentin e Edukimit Qytetar, që krijohet nga ish-Departamenti i Edukimit Qytetar dhe Gazetarisë.
 - b) Fakultetit të Shkencave Humane i bashkohet ish-Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe do të ketë në përbërje këto departamente:
 - Departamentin e Gjuhësisë, Letërsisë dhe Gazetarisë, që krijohet nga ish-Departamenti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Seksioni i Gazetarisë, pjesë e ish-Departamentit të Edukimit Qytetar dhe Gazetarisë;
 - Departamentin e Historisë dhe Gjeografisë;
 - Departamentin e Gjuhëve të Huaja, që krijohet nga bashkimi i ish-Departamentit të Gjuhës Angleze dhe ish-Departamentit të gjuhës gjermane, frënge dhe Italiane.
 - c) Fakultetit të Shkencave të Natyrës iu bashkohet ish-Shkolla e Lartë e Infermierisë dhe do të ketë në përbërje këto departamente:
 - Departamentin e Matematikës;
 - Departamentin e Fizikës;
 - Departamentin e Biologjisë dhe të Kimisë;
 - Departamentin e Infermierisë.
 2. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për vitin akademik 2007-2008, do të vazhdojë të ofrojë të njëjtat programe studimi, që ka ofruar me fillimin e këtij viti akademik.
 3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.822, datë 5.12.2007

PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT DHE RIORGANIZIMIN E NJËSIVE KRYESORE,
FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Universiteti Teknologjik “Ismail Qemali” të emërtohet Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

2. Në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë:

a) Krijohet Fakulteti i Edukimit, i cili të ketë në përbërje:

- Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe të Metodologjisë së Mësimdhënies, që krijohet në bazë të ish-Departamentit Ndërfakultetor të Mësuesisë;

- Departamentin e Formimit të Përgjithshëm, që krijohet në bazë të ish-Departamentit Ndërfakultetor të Mësuesisë;

- Departamenti i Gjuhëve të Huaja, që krijohet në bazë të ish-Departamentit Ndërfakultetor të Gjuhëve të Huaja.

b) Fakulteti i Tregtisë të emërtohet Fakulteti i Ekonomisë dhe i Drejtësisë, i cili të ketë në përbërje këto departamente:

- Departamentin e Biznesit;

- Departamentin e Turizmit;

- Departamentin e Drejtësisë.

c) Fakulteti i Marinës të emërtohet Fakulteti i Shkencave Teknike, i cili të ketë në përbërje këto departamente:

- Departamentin e Inxhinierisë Navale;

- Departamentin e Lundrimit;

- Departamentin e Teknologjisë së Informacionit.

ç) Fakulteti i Infermierisë shkrihet dhe organizohet në Departament të Infermierisë, që varet nga rektorati i Universitetit.

3. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për vitin akademik 2007-2008, do të vazhdojë të ofrojë të njëjtat programe studimi që ka ofruar me fillimin e këtij viti akademik.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.823, datë 5.12.2007

PËR KRIJIMIN E DISA NJËSIVE KRYESORE, FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT “EQEREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, krijohet Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, nga bashkimi i ish-Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe ish-Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

2. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, ka në përbërje këto departamente:

- Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe të Metodologjisë së Mësimdhënies, që krijohet nga bashkimi i ish-Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe ish-Departamentit të Arsimit Parashkollor;

- Departamentin e Gjuhëve të Huaja;

- Departamentin e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek;

- Departamentin e Historisë dhe Gjeografisë;

- Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë;

- Departamentin e Ekonomisë.

3. Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastër, për vitin akademik 2007-2008, do të vazhdojë të ofrojë të njëjtat programe studimi, që ka ofruar me fillimin e këtij viti akademik.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.824, datë 5.12.2007

PËR KRIJIMIN E DISA NJËSIVE KRYESORE, FAKULTETE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Universitetin Politeknik të Tiranës:

a) Krijohet Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, i cili të ketë në përbërje:

- Qendrën e Kërkimit dhe Zhvillimit në Teknologjitë e Informacionit, (INIMA);
- Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit, që krijohet nga ndarja e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike, ish-pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike;
- Departamentin e Inxhinierisë Informatike, që krijohet nga ndarja e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike, ish-pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike;
- Seksionin e Informatikës, ish-pjesë e Departamentit të Matematikës dhe Informatikës, në varësi të rektoratit.

b) Krijohet Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm, si fakultet i asociuar, i cili të ketë në përbërje:

- Departamentin e Fizikës dhe Kimisë, që krijohet nga bashkimi i ish-Departamentit të Fizikës dhe ish-Departamentit të Kimisë, të cilat kanë qenë pjesë përbërëse në varësi të rektoratit;
- Departamentin e Matematikës;
- Qendrën e Gjuhëve të Huaja, që krijohet nga ish-Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në varësi të rektoratit.

c) Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike riorganizohet dhe ka këto departamente:

- Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë;
- Departamentin e Elektroteknikës;
- Departamentin e Automatikës.

2. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike do të ofrojnë të njëjtat programe studimi, në të tri ciklet, që ofronte Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, të ndara sipas disiplinave përkatëse, struktura e të cilave përcaktohet nga vetë institucioni. Programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë do të riorganizohen sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për vitin akademik 2008-2009 do të ofrohen, pasi të miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

3. Diplomat e inxhinierisë fizike dhe inxhinierisë matematike të konsiderohen si diploma ndërdisiplinore. Përcaktimi i fakulteteve, që do të bëjnë administrimin e tyre, përcaktohet nga vetë Universiteti Politeknik i Tiranës.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr.828, datë 5.12.2007

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË E KORPORATËS
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH) DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS
ZVICERANE, PËR DHËNIEN E ASISTENCËS FINANCIARE (GRANT), PËR KRYERJEN E
STUDIMIT TË FIZIBILITETIT, PËR INVESTIMET PËR SIGURINË E DIGAVE, NË
KASKADAT E LUMENJVE, DRIN DHE MAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për dhënien e asistencës financiare (Grant), për kryerjen e studimit të fizibilitetit, për investimet për sigurinë e digave, në kaskadat e lumenjve, Drin dhe Mat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.829, datë 5.12.2007

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007,
MIRATUAR PËR DISA BASHKI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkive të mëposhtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’u shtohen fondet, si më poshtë vijon:

- a) Bashkisë Burrel 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë;
- b) Bashkisë Kamëz 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë;
- c) Bashkisë Bajram Curri 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;
- ç) Bashkisë Kukës 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë;
- d) Bashkisë Krujë 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë;
- dh) Bashkisë Shkodër 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;
- e) Bashkisë Berat 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Fondi prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe bashkitë Burrel, Kamëz, Bajram Curri, Kukës, Krujë, Shkodër e Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.838, datë 5.12.2007

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E
PRESIDENTIT, KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 6 të vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Pozicionet “Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit” dhe “Drejtor i Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj” në Kryeministri, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 8 000 (tetë mijë)

lekësh, në muaj, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Pozicionet “Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit” dhe “Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj”, në Kryeministri, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh në muaj, mbi pagën bazë mujore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 14.12.2007
Doli nga shtypi më 17.12.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 40 lekë